

PROGRAMI DHE STATUTI I LËVIZJES POPULLORE TË KOSOVËS

Prishtinë 1991

Programi dhe Statuti i LPRK-së për herë të parë u aprovua në Mbledhjen e Parë të Përgjithshme të LPRK-së në korrik të vitit 1987 (Programi u botua tri herë '87, '88 dhe '89). Në tetor 1991, Programi dhe Statuti u botuan në Kosovë në kuadër të materialeve të Mbledhjes së Tretë të Përgjithshme dhe me ndryshimet që i bëri ajo. Ky është botimi i 5-të. Botohet me vendimin e Kryesisë së Këshillit të Degës së LPRK-së jashtë vendit.

P R O G R A M I

I LËVIZJES POPULLORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

I

Përkundër luftës së parreshtur të popullit shqiptar për çlirim kombëtar, më se gjysma e trojeve etnike shqiptare të ripushtuara nga Serbia dhe Mali i Zi, u ndanë padrejtësisht nga trangu dhe mbetën jashtë shtetit shqiptar.

Pas LDB (Luftës së Dytë Botërore) trojet shqiptare nën Jugosllavi u copëtuan në tri Republika (Serbi, Maqedoni, Mal të Zi) dhe Krahinën e Kosovës, gjysëmautonome, edhe kjo në kuadër të Serbisë.

Rezultat i luftës së gjatë të popullit të robëruar shqiptar në Jugosllavi është shpallja e Republikës së Kosovës më 1990, realizimi praktik i së cilës pengohet egërsisht nga pushtuesit serbë.

Populli shqiptar, më se 3 milionësh në Jugosllavi, megjithëse për nga numri vjen në rend të tretë, menjëherë pas serbëve dhe kroatëve, dhe jeton në trojet e veta kompakte, ku është autokton dhe përbën shumicën absolute të popullsisë, i mohohet e drejta legjitime të vetëvendosë lirisht për fatin e vetë.

Populli shqiptar nuk u pajtuar dhe nuk do të pajtohet kurrë me këtë gjendje.

Ruga e vetme që shpie drejtë zgjedhjes së drejtë të çështjes sonë kombëtare është lufta e bashkuar e gjithë popullit tonë kundër pushtuesve sllavomëdhenj.

II

Lëvizja Popullore e Republikës së Kosovës (më poshtë LPRK) është organizatë demokratike nacional-çlirimtare që ka për qëllim:

- Zgjedhjen e çështjes kombëtare të popullit shqiptar të robëruar nën Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi në bazë të parimit të së drejtës së vetëvendosjes, duke përfshirë edhe të drejtën për shkëputje;
- Ndërtimin e shoqërisë së re, të lirë dhe demokratike shqiptare në përputhje me vullnetin e popullit.

III

Arritjen e këtyre qëllimeve LPRK-ja e sheh nëpërmjet bashkimit të gjithë popullit të robëruar shqiptar dhe forcave të tij të organizuara në një front të përbashkët pa dallim përkatësie klasore, ideologjike, fetare e krahinore.

LPRK në luftën e saj përdor të gjitha format dhe mjete demokratike, paqësore e politike të luftës. Në rrethanat kur janë të pashmangshme përdor edhe format e mjete jopaqësore si vetëmbrojtje popullore e domosdoshme.

LPRK kombinon format ilegale dhe legale të veprimit në përputhje me rrethanat dhe situatat që krijohen.

LPRK është kundër formave fashiste, raciste, anarkiste e terroriste të veprimit.

IV

LPRK faktor kryesor të luftës çlirimtare konsideron forcën e brendshme. Ndhimat nga jshtë realizohen nëpërmjet të këtij faktori.

LPRK përkrah të gjitha proceset progresive dhe demokratike në Evropë dhe botë.

V

Këtë Program mund ta ndryshojë Mbledhja e Përgjithshme apo organi të cilin e ngarkon ajo.

Aprovohet në Mbledhjen e Tretë të Përgjithshme të LPRK-së.

Tetor 1991, Kosovë

STATUTI

I LËVIZJES POPULLORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Lëvizja Popullore e Republikës së Kosovës (më poshtë LPRK) është Organizatë (politike) demokratike nacionalçlirimtare e pjesës së kombit të robëruar nën Jugosllavi (nga Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi).

LPRK-ja është pjesë përbërse e lëvizjes së popullit tonë në Jugosllavi për çlirim kombëtar.

LPRK-ja ka për qëllim që bashkë me të gjitha forcat përparimtare, patriotike e revolucionare, me të gjitha subjektet politike brenda popullit tonë të robëruar të ndihmojë formimin e frontit të përbashkët dhe të gjërë popullor (pa dallim përkatësie ideologjike, fetare, krahinore, etj.) për dëbimin e pushtuesve nga trojet tona të pushtuara.

LPRK-ja lufton për çlirimin e plotë të popullit shqiptar dhe për ndërtimin e shoqërisë së re shqiptare: të lirë, demokratike dhe të pavarur në përputhje me vullnetin Sovran të popullit.

I

- Anëtar i LPRK-së mund të jetë çdo person madhor që e pranon programin dhe statutin e saj që bën pjesë në njërin nga këshillat ose organet e Lëvizjes dhe që e ndihmon atë materialisht.*
- Anëtar i LPRK ka për detyrë:*
- Të zbatojë programin, statutin dhe vendimet e organizatës udhëheqëse të LPRK-së,*
- Të luftojë për të drejtat kombëtare e demokratike,*
- Të ruaj bashkimin dhe unitetin e radhëve të LPRK-së,*
- Anëtari i LPRK-së ka të drejtë:*
- Të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve të organizimit, të vijës politike etj., që i përkasin Lëvizjes;*
- Të bëjë pyetje, kritikë, kërkesë, njoftim, propozim dhe ankesë në të gjitha instancat e Lëvizjes.*
- Pranimi në LPRK dhe përjashtimi:*

- *Pranimi i anëtarëve në LPRK bëhet nëpërmjet të njërit nga këshillat e saj, pasi të jetë dhënë arsyeimi për kandidatin individualisht ose kolektivisht;*
 - *Varësisht nga pesha e fajit, anëtari i LPRK-së mund të kritikohet, t'i tërhiqet vërejtja, të dënohet me parapërgjashtim apo edhe me përjashtim kur shkilen rëndë normat e Programit dhe Stautit të Lëvizjes;*
 - *Shqiptimin e ndëshkimit e bën këshilli ose organi në të cilin bën pjesë anëtari;*
- ç) anëtari i denuar ka të drejtë ankese në organet më të larta të LPRK-së*
- d) shlyrjen e denimit ose kthimin në radhët e LPRK-së të anëtarit të përjashtuar e bën këshilli a organi që e ka shqiptuar dënimin me miratimin e organeve më të larta të LPRK-së;*

II

- *Organi më i lartë i LPRK është Mbledhja e Përgjithshme.*
 - *MP e LPRK-së mbahet një herë në dy vjet. Ndërsa, Mbledhja e Jashtëzakonshme mund të thirret nga Këshilli i Përgjithshëm (KP) ose me kërkesën e një të tretës së këshillave të rretheve;*
 - *Në MP marrin pjesë delegatët nga të gjitha këshillat e rretheve, anëtarët e KP, Kolegjiumi i Redaksisë së organit të LPRK-së dhe delegatë nga Dega e LPRK-së jashtë vendit;*
 - *Thirrjet dhe rendi i punës për MP bëhen të paktën një muaj përpara;*
- ç) MP diskuton raportet që i paraqiten nga organet e komisionet e Lëvizjes dhe pas vërejtjeve e plotësimeve i aprovon ato, shqyrton dhe vendos për kërkesat, ankesat, parashtresat etj., që i drejtohen asaj, përcakton vijën organizative dhe politike të Lëvizjes dhe detyrat e saj deri në Mbledhjen tjetër të Përgjithshme dhe aprovon rezolucionet e materialet tjera të saj si dhe zgjedh Këshillin e Përgjithshëm të LPRK-së.*
- 6. Këshilli i Përgjithshëm (KP) udhëheq punën në mes të dy MP.*
- a) KP e zgjedh Kryesinë e KP*
- 7. Kryesia e KP është organi ekzekutiv i KP e cila në bazë të vendimeve të MP të KP operacionalizon dhe përcakton detyrat që dalin prej tyre. Kryesia i thërret Mbledhjet e KP dhe paraqet*

raport para tyre. Në raste të veçanta formon edhe komisione të ndryshme.

8. LPRK formon edhe këshillat e rretheve si pjesë rajonale të saj, këshillat lokalë, si bashkësi e dy e më shumë fshatrave ose vendbanimeve dhe së fundi këshillin e fshatit-lagjes.

9. Jashtë vendit vepron Dega e LPRK-së:

a) mënyra e organizimit dhe veprimit të Degës jashtë vendit plotësohet me rregullore të veçantë e cila hartohet në pajtim me Statutin dhe Programin e LPRK-së

10. Këshillat e rretheve dhe Dega e LPRK-së para çdo mbledhjeje të Përgjithshme të LPRK-së mbajnë mbledhjet e përgjithshme të vetat.

11. Kolegjiumi i redaksisë bën punë propagandistike në bazë të Programit, të vendimeve të MP dhe KP. Kolegjiumi paraqet raport gjashtëmujor dhe vjetor para KP si dhe në MP të LPRK-së.

III

12. LPRK-ja ndërtohet në bazë të parimit territorial.

13. Jeta e brendshme organizative e LPRK-së bëhet mbi bazë të parimit territorial.

a) të gjitha organet udhëheqëse zgjedhen nga poshtë lart, me vota të fshehta dhe me shumë kandidatë;

b) vendimet mirren me shumicë votash ose njëzëri;

c) kolegjaliteti është parimi më i lartë i punës udhëheqëse të LPRK-së.

IV

14. LPRK-ja financohet nga anëtarësia, nga ndihmat dhe nga veprimtaria propaganduese.

15. Komisioni statutar i formuar nga MP, KP ose Kryesia e tij paraqet nevojën e ndryshimeve në Statut përpara këtyre organeve.

16. Ndryshimin e këtij Statuti mund ta bëjë MP e LPRK-së ose organi i autorizuar prej saj.

Tetor 1991, Prishtinë